



**NJERËZIT E TIJ
UDHËZUESI I DREJTUESIT**



PO Box 809,
St. Charles, IL 60174-0809 U.S.A.
awana.org
(630) 213-2000

© 2016 Awana® Clubs International

3 4 5 6 25 24 23 22

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, versioni 2009.
E drejta e autorit © SHOQËRIA BIBLIKE SHQIPTARE (ABS) TIRANË
Përdorur me leje.

Titulli në original: Trek 3 "His People" - Leader's Guide

Copyright 2017 Awana Clubs International

Originally published by Awana

1 East Bode Road

Streamwood, IL 60107-6658 U.S.A.

awana.org

(630) 213-2000

Ky libër u mundësua në gjuhën shqipe nga Qendra "IGNIS".

Për më shumë informacione vizitoni www.awana.al

Përktheu: Sara Gjana

Redaktoi: Linea Simeon

Korrekttoi: Ditjon Dibra

Shtypur në shtypshkronjën "Vision Printing shpk", Tiranë 2024

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla ABS 2009, përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.). Të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, incizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër, pa marrë leje me shkrim nga botuesi.

LETËR PËR DREJTUESIN:

Përschendetje! A jeni gati për të nisur një udhëtim? Do të zhytemi në historinë më të jashtëzakonshme që është treguar ndonjëherë. Ky libër shtron pyetjen: "Kush është me ty?". Do të bëni një përmbledhje të librit të Veprave. Nuk do të mbulojmë çdo detaj, por do të flasim për disa tema kryesore dhe se kush ishte me dishepujt e me Palin ndërsa po formohej Kisha. Edhe nëse nxënësit e tu sapo kanë filluar ta studiojnë Biblën, apo, edhe nëse janë rritur në kishë, kjo histori, historia e Perëndisë, është shumë e rëndësishme. Para se të filloni, kemi bërë një shpjegim sesi funksionon Trek-u. Gjithashtu kemi përfshirë pritshmëritë, në mënyrë që një drejtues të firmosë në fund të mësimit. Gati për të filluar? Le të nisim!

SI TË PËRDORNI LIBRIN E STUDIMIT BIBLIK TË TREK-UT

AKTIVITETI HYRËS

Nga t'ia nisim? Filloni këtu. Në fillim të çdo mësimi ka një aktivitet që duhet plotësuar, i cili do t'ju ndihmojë me prezantimin e mësimit. Kjo është një hapësirë ku ata mund të krijojnë, të vizatojnë, të vendosin foto, të bëjnë lista etj. Të gjithë nxënësit duhet ta plotësojnë këtë pjesë që drejtuesi të firmosë.

FJALA KYÇ

Çdo mësime ka një fjalë kyç. Fjala kyç përfshin përkufizimin e koncepteve nga çdo mësime. Të gjithë nxënësit duhet ta plotësojnë këtë pjesë, në mënyrë që drejtuesi të firmosë.

MENDIMI KYÇ

Mendimi kyç është fjalia që përshkruan se për çfarë flet mësimi.

MËSIMI

Mësimi biblik fillon me një pasazh nga Shkrimi. Mos e anashkaloni! Gjithmonë filloni me leximin e Fjalës së Perëndisë. Pastaj, lexoni studimin.

VARGU KYÇ

Vargu kyç është për t'u mësuar përmendsh. Nxënësit duhet të mësojnë vargun, në mënyrë që drejtuesi të firmosë. Nën vargun kyç ka një shpjegim të thjeshtë të kuptimit të tij (nxënësit e tu nuk duhet të mësojnë përmbledhjen që të plotësohet pjesa e mësimit). Sigurohu që nxënësit të mësojnë vargun dhe të dinë kuptimin e tij.

DEVOCIONET

Në fund të çdo mësimi, ka gjashtë devocione. Çdo pjesë nis me një pasazh të Shkrimit që duhet lexuar. Pastaj ka disa fjali mbi të cilat mund të meditoni dhe disa pyetje që duhet t'u përgjigjeni. Nxiti nxënësit ta fillojnë ose ta përforcojnë praktikën e të kaluarit kohë çdo ditë me Fjalën e Perëndisë. Nxënësit duhet ta plotësojnë këtë pjesë, që drejtuesi të firmosë.

ÇFARË KËRKESASH DUHET TË PËRMBUSHEN NGA NXËNËSIT PARA SE DREJTUESI TË FIRMOSË?

- Nxënësit duhet të plotësojnë aktivitetin hyrës në fillim të çdo mësimi.
- Nxënësit duhet të mësojnë përmendsh vargun kyç.
- Nxënësit duhet të plotësojnë pjesët e devocioneve.

SIGUROHU TË VIZITOSH FAQEN AWANA.AL PËR TË SHKARKUAR MATERIALET SHITESË TË TREK-UT.

Kemi përfshirë faqet prezantuese si burim mësimor shtesë. Çdo faqe përmban një nënfaqe me titullin, një me vargun kyç, një me përmbledhjen e mësimit dhe një faqe të ndryshueshme që ti mund ta përdorësh kur mëson studentët e tu.

PJESA 1: PËRGATITE

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT

Le të themi se ke ardhur në kishë qëkur ke qenë shumë i vogël. Ke dëgjuar disa qindra apo mijëra predikime. Ke ndihmuar me shërbesën e fëmijëve, ke marrë pjesë në dreka/darka me kishën, ke kënduar te kori dhe e ke mbushur librarinë e shtëpisë sate me manuale studimi të Biblës, me fletushka seminaresh dhe shënime nga takimet me bordin e kishës. Ndoshta, edhe në kohën e lirë je përkushtuar dhe ke marrë një certifikatë në studime biblike nga një shkollë biblike. E njeh të vërtetën për Jezusin në majë të gishtave. Ke studiuar dhe i ke vënë në praktikë dhuntitë e tua në kishën vendore për t'u shërbyer njerëzve dhe për t'i dashur ata. A e ke bërë vetëm? A është e mundur të jesh dëshmitar i Jezusit, nëse Fryma e Shenjtë nuk punon në jetën tënde?

Dishepujt kishin kaluar tri vite me Jezusin. Ata ndiqnin dhe mësonin nga vetë Mjeshtri. Jezusi do të largohej për të shkuar tek Ati. Ai do të largohej për të përgatitur një vend për ata që besojnë në Të. Mirëpo, me largimin e Tij, Jezusi

ua la dishepujve detyrën për të vazhduar misionin që Ai nisi. Ky grup njerëzish të zakonshëm do të ndryshonte botën me ungjillin, në kuptimin e plotë të fjalës. Megjithatë, një mision kaq i rëndësishëm nuk peshonte vetëm mbi shpatullat e tyre. Jezusi tha se Ngushëlluesi do të vinte, dhe se pas largimit të Tij, ata nuk do ta kryenin vetëm këtë mision. Fryma e Shenjtë do të vinte dhe me Të do të vinte edhe fuqia me të cilën dishepujt do të bashkëpunonin për të arritur botën.

Veprat 1:8 është një përshkrim shumë i përmbledhur i librit të Veprave. Fryma e Shenjtë do të vinte, pikërisht ashtu siç kishte thënë Jezusi. Pastaj ungjilli do të shpërndahej nga një qytet, tek një shtet, në një rajon e deri në skajet e botës. Jezusi u dha dishepujve një mision – një mision të vështirë – që do të kërkonte më shumë fuqi se ç'kishin ata vetë. Por Ai gjithashtu u premtoi se do të siguronte të gjithë fuqinë për të cilën ata do të kishin nevojë, që ta kryenin misionin.

PJESA KRYESORE NGA SHKRIMI

VEPRAT 1:1-11

PJESËT DYTËSORE NGA SHKRIMI

LUKA 24:49, MARKU 16:19,

MATEU 28:19, MATEU 24:36

🔑 FJALA KYÇ:

FUQI | Aftësia për të bërë diçka apo për të vepruar në një mënyrë të veçantë për të përmbushur një qëllim specifik

🔑 MENDIMI KYÇ:

Kur Perëndia u jep dishepujve të Tij një mision, Ai premtun se do të sigurojë të gjithë fuqinë që u duhet për ta përmbushur atë mision.

🔑 VARGU KYÇ:

“Por do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të më bëheni dëshmitarë në Jerusalem dhe në gjithë Judenë dhe Samarinë dhe deri në skajin e dheut.”

Veprat 1:8

OBJEKTIVAT E MËSIMIT

- Nxënësit do të dinë se Jezusi u dha dishepujve të Tij një mision.
- Nxënësit do të dinë se misioni kërkonte më tepër fuqi nga se kishin ata vetë.
- Nxënësit do të dinë se Jezusi ua dha dishepujve misionin bashkë me premtimin e fuqisë.

OBJEKTIVAT E TUA

Ti i njeh nxënësit e tu. Në bazë të këtij mësimi, çfarë objektivash mësimore dëshiron të arrish sot?

1.1 PJESA 2: LOJËRA (NDËRVEPRIM)

Përdor hapësirën e mëposhtme për të planifikuar dhe për t'u përgatitur për kohën e lojës. Pjesa e sipërme e faqes ka lojëra dhe ide që janë zgjedhur paraprakisht për t'iu përshtatur përmbajtjes së mësimin. Përdor pjesën tjetër të faqes për të planifikuar lojërat e tua. Ti i njeh nxënësit e tu dhe e di se çfarë do të funksionojë më mirë për ta.

Loja 1 – Alienët përballë grabitqarëve (Shih librin e lojërave *Awana*, faqja 6, për listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Loja 2 – Garë me fashë/rrip (Shih librin e lojërave *Awana*, faqja 16, për listën e materialeve dhe shpjegimin e lojës.)

Projekti i shërbesës – A mund të kem një dëshmitar? Në kishën tënde ka njerëz që shërbejnë çdo javë për orë të tëra dhe ndonjëherë askush nuk i vë re. Mblidhi nxënësit dhe përpikuni të gjeni se kush pastron lodrat e fëmijëve, kush mbledh plehurat, kush përgatit sallën për shërbesë, kur përgatit vaktet dhe kush e drejton shërbesën e fëmijëve çdo javë. Kërkoju nxënësve t'i bëjnë një foto atij personi, pa e vënë re ai. Printojeni foton dhe pranë saj vendosni një letër ku shkruhet: "Të vumë re që po i shërbeje Perëndisë në mënyrë të mrekullueshme. Faleminderit!" Kështu do të shikoni sesa njerëz janë dëshmitarë të fuqisë dhe punës së Perëndisë në kishën tënde.

PLANIFIKO - ÇFARË DO TË BËSH SOT?

KOHA:

KALIMI

Si do t'i ndihmohesh të kalojnë nga të qenët të rrëmujshëm në gatishmëri për të mësuar Fjalën e Perëndisë dhe për t'u përfshirë në të?

IDE:

Videoklip: –

Inskenim –

Mikser –

Adhurim –

LAJMËRIME

Cilat janë dy gjërat më të rëndësishme që nxënësit duhet të dinë para se të largohen sot?

JO MË TEPËR SE DY!

-
-

QË NGA DITA E PARË E STUDIMIT BIBLIK

Ja cili është misioni yt. Zgjidh një nga personat e mëposhtëm dhe shërbeju atyre:

1. Dikë në shtëpi (Mund t'ia lash dhe t'ia palosësh të gjitha rrobat.)
2. Dikë në komunitet (Mund t'i japësh disa rroba ose ushqim.)
3. Dikë në botë (Mund t'i dërgosh një kuti kujdesi personal një misionari vendas përmes kishës.)

Nëse ke nevojë për ide specifike, pyet drejtuesin ose një nga prindërit. Shpjego më poshtë se cilin person zgjodhe dhe përmblihdh me pak fjalë se çfarë bëre për të.

RAPORT MISIONI:

Misioni:

Aftësitë e përdorura:

Rezultatet e misionit:

NDJEKJA : Mendo për mënyra të tjera se si mund të kryhet misioni, nëse aftësitë e tua do të kombinoheshin me aftësitë e personave të tjerë në grup.

PLANIFIKO - MËSIMI I GRUPIT TË MADH

Prezantimi:

KOHA:

1.1 PJESA 3: MËSOJE (GRUP I MADH)

PËRMBLEDHJA E MËSIMIT

Misioni

“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj të gjitha kombet duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, duke i mësuar të mbajnë të gjitha sa ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen.”

Mateu 28:19-20

Forca

Dhe, duke u mbledhur bashkë me ta, i urdhëroi që të mos largoheshin nga Jerusalemi, por të prisnin premtimin e Atit: “Që e keni dëgjuar nga unë, tha Jezusi, sepse Gjoni pagëzoi me ujë, por ju do të pagëzoheni me Frymën e Shenjtë, mbas jo shumë ditësh”.

Veprat 1:4-5

“Por do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju.”

Veprat 1:8a

🔑 VARGU KYÇ:

“Por do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të më bëheni dëshmitarë në Jerusalem dhe në gjithë Judenë dhe Samarinë dhe deri në skajin e dheut.”

Veprat 1:8

Metoda

“Dhe do të më bëheni dëshmitarë në Jerusalem dhe në gjithë Judenë dhe Samarinë dhe deri në skajin e dheut.”

Veprat 1:8b

PËRMBLEDHJA JOTE E MËSIMIT

ZBATIMI

Kërkoju nxënësve të ndezin dritën pa shtypur çelësin. Kërkoju të ndezin telefonin që s'ka bateri. Kërkoju të pastrojnë me fshesë me korrent pa e vendosur në prizë. Nuk mund të bësh shumë gjëra pa pasur fuqi. Kishte një arsye shumë të rëndësishme përse dishepujt duhet të prisnin ardhjen e Frymës së Shenjtë. Jezusi nuk donte që dishepujt ta bënin këtë detyrë shumë të rëndësishme vetëm, apo pa fuqi hyjnore.

Këtu marrim një mësim të rëndësishëm për shërbesë. Kur shërbëtorët në kishën e Jezusit shërbejnë, është e rëndësishme të mos shërbejnë kurrë vetëm. Shërbesa ka për qëllim të përfshijë të tjerët. Vër re se Jezusi nuk thotë: "Filloni ju, dhe kur të keni bërë një pjesë të punës, atëherë do të shfaqet Fryma e Shenjtë". Jo! Ai dëshiron që dishepujt të presin për Frymën e Shenjtë. A ke dashur ndonjëherë të nxitosh në shërbesë, pa e ftuar më parë Perëndinë ose pa e pritur Atë? Dishepujt bënë gjëra të mrekullueshme. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk u bë një i famshëm narcist. Ata ishin një grup shërbëtorësh që thjesht i përgjigjeshin me "Po" Perëndisë dhe e prisnin Atë.

ZBATIMI YT

🔑 FJALA KYÇ:

FUQI | Aftësia për të bërë diçka apo për të vepruar në një mënyrë të veçantë për të përmbushur një qëllim specifik

🔑 MENDIMI KYÇ:

Kur Perëndia u jep dishepujve të Tij një mision, Ai premtan se do të sigurojë të gjithë fuqinë që u duhet për ta përmbushur atë mision.

Diskutoni pyetjet e mëposhtme:

- Kur ka qenë hera e fundit që grupi ka bërë një shërbesë dhe e ka nisur duke ftuar Perëndinë të jetë pjesë e shërbesës?
- Kush është Fryma e Shenjtë? Çfarë bën Ai dhe përse e bën?
- Përse nuk duhet të shërbejmë kurrë vetëm? Përse është e rëndësishme?

1.1 SEKSIONI 4: DISKUTOJE (GRUP I VOGËL)

PYETJE PËR TË FILLUAR:

KOHA:

Përse mendon se Perëndia donte që dishepujt të prisnin për Frymën e Shenjtë? Shpjego.

Përse është e vështirë t'i bindemi Perëndisë pa ditur gjithçka më parë? Përse duhet t'i bindemi gjithsesi?

Marrë nga Pjesët 3-7 të studimit biblik

PJESA 3

LEXO: VEPRAT 1:1-3

Pasi kishte shpjeguar qëllimin e ungjillit të tij, Luka gazetari, fillon t'i lidhë këto dy histori me njëra-tjetrën. Në vargun 3, ai përdor një fjalë të rëndësishme: *prova*. Jezusi u dha shumë prova njerëzve se Ai ishte i gjallë sërish, në një trup fizik, duke ngrënë e duke marrë frymë. Dëshmitarët okularë e panë dhe ua treguan të tjerëve.

ZBULO:

Përse Jezusi u siguroi që njerëzit të kuptonin se Ai ishte vërtet i gjallë pas ringjalljes? Cili do të kishte qenë ndryshimi nëse Jezusi do të ishte thjesht frymë?

PJESA 4

LEXO: VEPRAT 1:4-5

Jezusi kishte një mision shumë të madh për dishepujt, por Ai nuk donte që ata të fillonin menjëherë. Ai donte që dishepujt të prisnin fuqinë e Frymës së Shenjtë.

ZBULO:

Cfarë të ka kërkuar Perëndia të bësh me fuqinë e Tij? Përse ne përpiqemi të bëjmë atë që Ai na kërkon, pa fuqinë e Tij?

PJESA 5

LEXO: VEPRAT 1:6-8

Dëshmitarët kanë një punë: të tregojnë çfarë kanë parë. Nuk është detyra e një dëshmitari të bindë dikë se historia që po tregon është e vërtetë. Dëshmitari thotë thjesht: "Kjo është përvoja ime".

ZBULO:

Si do ta përshkruaje me pak fjalë përvojën tënde me Jezusin?

PJESA 6

LEXO: VEPRAT 1:9-11

Duket si pyetje qesharake: Ku tjetër mund të shikonin dishepujt pasi Jezusi u ngrit mbi re? Por ajo që engjëjt thanë, kishte të bënte me premtimin: Ai po kthehet.

ZBULO:

Përse është e rëndësishme për ty që Jezusi do të kthehet një ditë në tokë? Si të ndihmon kjo të kesh më shumë siguri për t'i treguar njerëzve historinë tënde?

PJESA 7

Çfarë të vërtete mësove këtë javë? Çfarë do të bësh me këtë të vërtetë?

1.1 SEKSIONI 5: VLERËSOJE

NDIHMESE

Bëjua të qarta pritshmëritë nxënësve. Shumë grupe të vogla nuk ecin mirë gjatë vitit, thjesht sepse drejtuesi nuk i qartëson pritshmëritë e tij. Nise vitin siç duhet, duke treguar se cilat janë pritshmëritë e tua për kohën që kalon me nxënësit. Jepu udhëzime! Cakto qëllime dhe objektiva. Mos hamendëso se nxënësit e dinë se çfarë pritjet prej tyre kur hyjnë në klasë. Bëji të qarta pritshmëritë! Nëse do ta bësh këtë që në fillim, do të kursesh shumë kohë gjatë vitit.

NDJEKJA

Ndonjëherë është e vështirë të kujtosh të gjitha kërkesat e lutjeve dhe të gjitha gjërat që ndodhin në jetën e nxënësve të tu. Përdore këtë hapësirë për të shënuar pikat e lutjes, informacionet e kontakteve të nxënësve, oraret e takimeve dhe informacione të tjera. Ose përdore që nxënësit e tu të shënojnë kur është ndeshja apo koncerti i tyre i radhës.

DATA	EMRI	KËRKESAT / NGJARJET / KONTAKTET

VLERËSIMI

Çfarë shkoi mirë... çfarë nuk shkoi edhe aq mirë? Shkruaj se si shkoi takimi dhe kaloni kohë me drejtuesit e tjerë duke diskutuar vazhdimisht për këto gjëra. Vlerësimi i vazhdueshëm ndihmon në përmirësimin e asaj që bën dhe gjithashtu e bën mësimin tërheqës për nxënësit çdo javë.

Përgatite –

Lojëra –

Mësoje –

Diskutoje –